



Npi – 01/118 datë: 10.06.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 10.06.2020 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S S Ë -IV- T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S

E mbajtur më: 10.06.2020, e (mërkurë) në ora 10.^{oo} h. në sallën e Shtëpisë së Kulturës për arsye të përhapjes së Pandemisë KOVID19 e njohur si (Korona-Virus).

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Medina Brahaj, Perparim Ramusa, Shefki Dauti, Herolind Selmani, Reshat Mujota, Arbresha Syla, Milot Deliu, Fatmire Ferati, Naim Zejna, Skender Hyseni, Zarife Rexhaj, Valentina Halili-Ferati, Ruzhdi Jashari, Besnik Seferi, Marigona Pajaziti, Fehmi Hysenaj, Adelina Beqaj, Isak Muslija, Diarta Vishesella, Muhamet Ademaj, Rexhep Gashi.

Përveç delegatëve në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët; z.Lumni Amrushi, znj.Shqipe Rexhaj, znj.Agime Roshaj; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj; Zyrtarët e IT-së Gazmend Ademaj dhe Shpëtim Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i ekstrakt procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 27.02.2020 dhe 01.04.2020,
2. Pyetje – Përgjigje,
3. Raporti vjetor Financiar për vitin 2019,
4. Raporti tremujor buxhetor Janar-Mars 2020,
5. **Rishikimi i Buxhetit për vitin 2020. (Pikë Shtesë)**
6. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023,
7. Rishqyrtimi i vendimeve të Kuvendit sipas raportit të vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ë,
8. Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave,

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, tha për shkak të zhvillimeve të shpejta nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila dje ka dërguar propozimin për “Rishikimin e Buxhetit për vitin 2020”, me procedure të shpejtë, ju kemi njoftuar me kohë për shtyrjen e mbledhjes së Rregullt të Kuvendit për 2 ditë, nga data 08.06.2020, në datën 10.06.2020, me qëllim që ta fusim si pikë shtesë për trajtimin edhe “Rishikimin e Buxhetit për vitin 2020”. Kështu që unë po propozoj që ta fusim si pikën e 8 shtesë të rendit të ditës. Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Shefki Dauti; Përshëndetje, në emër të grupit delegatëve të PDK-së propozoj që ta miratojmë këtë rend dite me pikën shtesë të propozuar nga Kryesuesja e Kuvendit.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, unë propozoj që në rendin e ditës ta fusim edhe një pikë të re shtesë “Implementimi i plotë i vendimit të Kuvendit për largimin e të gjitha Kiosqeve te shkolla “Emin Duraku”-Shtime, dhe lirimi i të gjitha hapsirave publike”.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Kemi pra dy propozime, unë po e vej në votim propozimin e parë me pikën shtesë për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2020. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi rendin e ditës me pikën shtesë nr.8: “Rishikimi i Buxhetit për vitin 2020”, sipas propozimit të Kryesueses së Kuvendit.**

Pika 1

Shqyrtimi i ekstrakt procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 27.02.2020 dhe 01.04.2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Konsideroj se trajtimi i propozimeve nga Kryesuesja dhe qitja në votim e propozimeve nuk është në rregull e ju trajtone si të doni. Kam vërejtje në procesverbalin e mbledhjes së Jashtëzakonshme të datës 01.04.2020, kërkoj që të evidentohet në procesverbal se as fjala ime e as e Kryesueses nuk është evidentu në procesverbal, që kam kërkuar të deklarohet Kuvendi.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 14 vota ”Për” dhe me 4 vota “Abstenim” aprovoi të dy Ekstrakt Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 27.02.2020 dhe 01.04.2020, me vërejtjen e z.Naim Zejna.**

Pika 2

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademmaj; Kam pyetje për drejtoreshën e DPUKGJ znj.Shqipe Rexhaj, 1. Sa leje ndërtimore i keni lëshuar në vitin 2019? 2 . Sa objekte ndërtimore janë ndërtuar pa leje gjat vitit 2019? dhe 3. Sa objekte pa leje janë rrënuar deri më tani? Pyetja tjetër është për drejtoreshën e DKA znj.Agime Roshaj, 1. Si është monitoruar mësimi On-line? 2. Sa për qind e nxënësve kanë qenë aktiv, në mbajtjen e mësimit nga distanca?

z.Fehmi Hysenaj; Përshëndetje, rreth kësaj pike për qdo herë po duhet me ngritë shqetësimin tim sepse ekzekutivi shumë pak po përgjigjet në pyetjet tona, nga 6 pyetje që i kam bërë në mbledhjen e kaluar e kam marrë vetëm një përgjigje. Përkundër kësaj unë i kam disa pyetje në emër të subjektit politik Nisma Social Demokrate, Pyetja e parë ka të bëjë me trotuarin në rrugën e Llanishtit, disa pjesë të asfaltit në ato trotuare mungojnë, kurse disa pjesë janë komplet të rrënuara dhe të shembura në lumë? 2. Në pjesët e hyrjes së qytetit me të cilën krenohet Komuna e Shtimes shpeshëher, shtigjet për bicikleta, kur është vendosur ai asfalt është tepër i vrazhdë në shumicën e rasteve ka barriera të mëdha ku realisht nuk do të duhej të kishte sepse asnjë ngarkesë nuk e kanë ajo rrugë ka qenë dashur të jetë shumë e rrafshët, e keni vërejtur se biciklistët vozisin nëpër trotuar të këmbësorëve për shkakt të vrazhdësisë në atë trotuar? Pyetja tjetër 3. Kur do të pastrohen trotuaret rreth Lumit Shtimjanja, ku janë shetitoret? Njëra pjesë është bllokuar sepse qe disa vite nuk është pastruar dhe tjetra pjesë është pranë bllokimit për shkak të vegjetacionit. 4. Kërkoj qoft nga Kryetari ose nëse e sheh të arsyeshme edhe drejtorja që të na jep arsyet reale të dorëheqjet të dy drejtorëve komunal dhe të dorëheqjeve të disa drejtorëve të shkollave?

z.Skender Hyseni; Përshëndetje, unë kam disa pyetje, pyetja e parë për DPUKGJ-në, kur po flasim për Trotuare nëpër fshatra, siq e dini unë disa herë e kam ngritur qështjen e mungesës së trotuarit në fshatin Muzeqinë, i cili është jo vetem i nevojshem por i domosdoshem për shkak të numrit të madh të nxënësve që qarkullojnë nëpër rrugë deri në shkollë dhe anasjelltas. 1.Pytja është a është najherë në rendin e ditës ndërtimi i trotuareve edhe ndriqimit në fshatin Muzeqinë? Kolegu pak më parë kërkoj qështjen e pastrimit të trotuarit rreth lumit unë kisha me pyet, 2. A është në rend dite pastrimi dhe

rregullimi i shtratit të Lumit Shtimjanja? 3. A ka program për këta bujqit e komunës tonë, që së paku ti gëzojmë me diqka? Sepse po shihet nëpër komunat tjera që po thonë se muarën atë e atë duke u ndihmuar.

z.Ruzhdi Jashari; Po shihet se çka po ndodhë në këtë Kuvend ku fjala e lirë e publike e anëtarëve të Kuvendit po insitohet me u zhduk, qasje për publikun nuk ka, nuk ka transparencë për qështjet çka po ndodhin në Kuvend. Pytja konsiston direkte për DPUKGJ-në, 1. Pse ipet leje, mbi vendimin e Kuvendit të Komunës, për ndërtim në oborin e Shkollës “Emin Duraku” në kundërshtim me vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, të vitit 2018, për largimin dhe mënjanimin e të gjitha Kiosqeve. Propozimin e vendimit atëherë e kanë bërë së bashku DSHP-ë dhe DPUKGJ-ë, ndërkaq në anën tjetër shkilet vendimi. Këto shkelje të vendimeve janë anti Ligjore, janë vepra penale e të cilat me këmbëngulësi mbrohen nga Kryesuesja e Kuvendit për mos me i futë për diskutim në rendin e ditës. Pyetja është direkte për çka Vendimi i Kuvendit me u shkelë. Njëra drejtori thot jemi duke rrënuar dhe tjetra, aty jep leje ndërtimi, këto janë faqe të zeza, pastaj japin dorëheqje drejtorat njëri pas tjetrit, kështu dalin në sipërfaqe pazaret e votave.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, unë e kam një pyetje konkrete për DPUKGJ-në 1. Po kërkoj prej vitit 2015, cilat parcela i kenë shpronësuar, në çfarë sipërfaqe në çfarë vlere, dhe kush ka qenë, a ka qenë zyra për vlerësimin e këtyre parcelave të inspektuara?

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, unë i kam 3 pyetje, por paraprakisht më lejoni të them se pak është shqetësuese trajtimi i grupit tonë si këshilltar të Kuvendit Komunal, e aq më tepër është shqetësuese qështja që për shumë këshilltar të Kuvendit Komunal edhe uzurpimi i pronave publike, qitne dorën në zemër të gjithë kur e përfaqësojmë interesin qytetarë që duhet ta bëjmë në mënyrën më dinjitoze për çka edhe jemi zgjedhur. 1. Pyetja është për fshatin Rashincë konkretisht për rrugën “Qorrolli” ku qysh nga viti 2019 kanë filluar disa punime për rregullimin e kanalizimit dhe asfaltimit të asaj rruge, e di që kanalizimi një pjesë e madhe e projektit ka përfunduar, mirëpo pjesa tjetër ende jo, gjendja e asaj rruge është vërtet në gjendje jo të mirë dhe ai shqetësim i qytetarëve është i bartur te ne, dhe pyetja është kur do të ketë realizim ky projekt? Po bëhen tash që 6 muaj, që kur ka filluar realizimi i këtij projekti por ende nuk ka përfunduar. Pra kur do të përfundojë ky projekt dhe kur do të ketë qasje të lirë për qytetarët me veturë. Pyetja e dytë, ka qenë dashur që të jetë Kryetari i Komunës këtu pasi që pyetja ka qenë direkte për të, ku në mbledhjen paraprake e kam pyetur Kryetarin mirëpo nuk më është dhënë përgjigje, ajo ka të bëjë me fshatin Topillë, ku dihet mirë që ka qenë një projekt me vlerë prej dikund 800.000€ projekt ky që është dashur të përfundojë në vitin 2019, mirëpo jemi tash më në vitin 2020 mirëpo nuk kemi realizim të projektit, prandaj këto 800.000€ po më intereson ta di se ku janë, ku kanë shkuar, pse nuk është dashtë të përfundohet ky projekt, edhe pse ka qenë në diskutim dhe një pompozitet jashtëzakonisht i madh nga zëvendësministri i atëhershëm zotëri Fehmi Mujota, poashtu edhe nga Kryetari i jonë i Komunës zotëri Ismajli. Prandaj po pyeti për banorët e fshatit Topillë çka ka ndodhur me këtë projekt, pse nuk është realizu edhe a duhet që këta qytatarë ta hjekin këtë problem të asfaltimit të kësaj rruge njëher e përgjithëmon. Pyetja e tretë është për fshatin Petrovë, dihet mirë që në buxhetin e vitit 2020 të aprovuar në vitin 2019 dmth. kemi futur edhe projektin për rregullimin e dy urave në këtë fshat, prandaj më intereson ta di, deri po bejm thirrje për specifikim të projekteve atëherë po dua ta di saktësisht se ku do të ndërtohen këto ura, pyetja pra është kështu a do të jetë e përfshirë në këtë projekt të urave edhe ura e vogël “Halil Hysenaj” edhe nëse po duhet ta dimë këtu që paraprakisht këto përgjigje të na ipen në mënyrë të drejtpërdrejt e jo që pastaj të jetë mundësia e përgjigjeve tona me jo e me po.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, fillimisht pata dëshirë që kolegut paraprak ti them që nuk ka nevojë ai të shqetësohet për neve, se nëse është për me u shqyrtu, e qesim ne vetë. E dyta për hirë të transparencës dhe për hirë të qytetarëve, kisha kërkuar nga drejtoresha e urbanizimit, nëse është e gatshme që të përgjigjet që në këtë mbledhje për shqetësimin e Ruzhdiut, për ndërtimin pa leje në oborin e shkollës fillore.

znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Përshëndetje për të gjithë, unë desha të jap vetëm një sqarim, për disa pyetje që u ngritën. Drejtorja për Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe

Gjeodezi, lëshon leje ndërtimore, ndërsa qka bëhen ndërtime jashtë pa leje, sa rrënimet bëhen nuk është kompetencë e DPUKGGJ-së, kjo pra është kompetencë e Drejtorisë për Shërbime Publike me Inspektorat. A ndodhin rrënimet sipas rregullave apo jo, edhe kjo nuk është kompetencë e jona. Ndërsa për pyetjet tjera psh. të pyetjes së Muhemetit, Idajeti ja dërgon përgjigjen me shkrim nga Drejtoria për Shërbime Publike se sa rrënimet janë bërë gjatë vitit 2019 dhe sa ndërtime pa leje ndërtimore janë prishur, nga DSHP-ja pra e jo nga DPUKGGJ-ë.

Pika 3

Raporti vjetor Financiar për vitin 2019

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha znj. Kimete Ukaj.

znj. Kimete Ukaj, ZKF; Përshëndetje, Raporti është përgatitur sipas rregullave të Kontabilitetit për raportet vjetore financiare. Baza ligjore e raportit është e paraparë me Ligjin për financat publike dhe përgjegjësitë. Në vazhdim znj. Kimete Ukaj lexoi raportin sipas tabelave financiare bazuar në Kodet buxhetore. Raportin financiar për vitin 2019 e keni marrë me kohë i përgatitur në mënyrë të detajuar, kështu që unë i mirpres pyetjet ose sygjërimet e juaja, (shih dokumentin) pres që pas diskutimeve këtë raport ta miratoni.

z. Perparim Ramusa; Unë e kam lexuar raportin, dhe propozoj që Kuvendi ta aprovojë.

z. Muhamet Ademaj; E falënderoj Kimeten për raportin. Ky pra është raport i shpenzimit të Buxhetit të Komunës së Shtimes. Shihet se është planifikuar dhe shpenzuar mirë. Buxheti është shpenzuar 85.87 %. Ne e dimë fare mirë se është gati e pamundur që Buxheti të shpenzohet 100%. Për mua është shqetësues fakti i mungesës së drejtorave në mbledhjet e Kuvendit dhe të Komiteteve.

z. Rexhep Gashi; E falënderoj ZKF-në për raportin. Raporti është ky që është. Unë raportin e kam lexuar dhe kam hasur në shumë parregullsi, si mund të shihet se janë ngatrruar faturat, kur nuk është dhënë se si është planifikuar ai projekt. Ka raste kur e kwemi pas vetëm një operator psh. për Karburante. Shpenzime rreth 5000€ janë shpenzime procedurale, qka ka ndodhur me këto pare? Kush do të jep llogari për këto keqmenaxhime që janë bërë, që kan shkuar në Gjykatë e të cilat e dëmtojnë Buxhetin e Komunës.

z. Naim Zejna; Replikë me Rexhep Gashin, lidhur me detyrimet kontigjente, ku kemi një proces gjyqësor mes stafit të mësimdhënësve të shkollës Profesionale dhe Komunës. Këtu pra kemi një papërgjegjësi të stafit administrativ të Komunës, dhe këtu duhet me dhënë dikush përgjegjësi.

z. Ruzhdi Jashari; Poqëse dikush punon mbi bazën e drejtësisë, ai do të jetë i linquar, prandaj unë fare nuk po befasohem me sjelljet e Kryesueses së Kuvendit. Kur ka marrë vendim Kuvendi për me e kompenzuar firmën “Beta” kam pa në raport se kemi një kompensim kësaj firme në shumën prej rreth 100.000€. Prandaj për mua nëse ky raport kalon për mua është absurditet. Firmës “Technopolis” ja keni dhënë vetëm tokën dhe asgjë tjetër, por ajo që po shihet në raport, po shihet se është në kundërshtim të plotë me shpenzimin e parasë publike. Në këtë Kuvend ne kemi kërkuar listën prioritare për shpronësimin e tokave. Pyetja është cili Komision e ka bërë vlerësimin e tokave. Unë po diskutoj për qështjet jetike për qytetarin. Ka edhe kërcënime sepse po punohet për dikend ndryshe e për dikend tjetër, ndryshe, unë e kam dokumentin që janë dhënë për kushte ndërtimore për leje ndërtimi, përkundër Vendimit të Kuvendit që te shkolla fillore duhet me i hjekë të gjitha Kioskat. Përkundër këtyre parregullsive të mëdha që ndodhin ne i shohim në ekzekutiv të njëjtat fëtyra. Shyqyr që e kemi mundësinë për me votuar “kundër” e ju votoni “për”. Këto janë të pa pranueshme, kjo është kërkesë për të filluar hetimet prokuroria për këtë firmë “Beta” duhet parë se në far mardhanje qëndron kjo firmë me Kryetarin.

z. Fehmi Hysenaj; E falënderoj ZKF-në për raportin i cili ka 48 faqe. Unë e kam analizuar dhe kam disa vërejtje. Por fillimisht kam vërejtje për mbledhjen që po e mbajmë këtu në sallën e Kuvendit sepse mendoj se nuk kemi kushte të mira për punë për shkak të mundësis së përhapjes së koronavirusit. Unë e di sa ka vende më të përshtatshme, ndoshta edhe do të ishte mirë që të shfrytëzohej edhe Koridori i Shkollës ku do të adaptohej me tavolina dhe do të ishte më mirë se këtu. Sa i përket raportit unë kam disa vërejtje duke filluar nga Planifikimi. Te pika e parë thuhet mbrojtja e tokës bujqësore, ku

vërtetë kjo është qesharake, sepse në komunën tonë aspak nuk mbrohet toka bujqësore. Unë nuk e di se si paguhen edhe 8 punëtorë më shumë që janë punësuar. Kam vërejtje të shpenzimeve kontigjente, sidomos sa u përket punëtorëve arsimor. Disa punëtorë të administratës i ka kthyer në punë Gjykata e Komuna i ka paguar ata pa punuar fare. Kështu që unë jam kundër aprovimit të këtij Raporti.

znj.Arbresha Sylaj; Përshëndetje, unë të them të vërtetën nuk ndjehem shumë profesionale në këtë pikë. Disa kolegë deputet i kapin për shqyrtim vetëm elementet negative të raportit financiar. Unë kam pa se ka një rritje të buxhetit komunal dhe kjo nuk potencohet fare. Është përmendur disa herë kontesti në mes shkollës profesionale dhe Komunës, unë mendoj se kjo qështje është qëllimkeq sepse edhe është sqaruar disa herë. Nuk duhet diskutuar vetëm për të hedhur poshtë të arriturat, dhe të mashtrohet qytetari. Vërejtjet duhet të kenë qëllim përmirësimi për të ardhmen. Diskutimet që po bëhen kryesisht janë politike, unë ju kisha preferuar që le ti drejtohen organeve kompetente e mos të na e marrin kohën këtu edhe neve por edhe qytetarëve.

z.Shefki Dauti; E falënderoj Kimeten për raportin, që ka të bëjë me rrjedhën e parasë publike. Kemi pas informata edhe prej drejtorive për shpenzimet që kanë ndodhur nëpër drejtori. Sa i përket shpenzimeve kontigjente unë mendoj se duhet të marrim sqarime më shumë sepse është një vlerë mjaft e madhe e shpenzimeve. Sa i përket raportit shohim se janë të spjeguar, ndërsa nëse nuk e aprovojmë raportin nuk ndryshohen shpenzimet. Kështu që unë jam që parimisht të kalojë.

z.Naim Zejna; Unë pajtohem me një pjesë të fjalës së Fehmiut, sepse vërtetë po e shohim që nuk kemi kushte të punës këtu. Është e natyrshme që duhet të sqarohet mirë sepse 2.300.000€ është huamarrje, nuk është vepër e jona. Pajtohem që shpenzimet kapitale janë shumë të mëdha. Pastaj nuk ka qenë nevoja që në raport të shkruhet Naim Zejna, por ka mundur që të shkruhet vetëm Grupi i LDK-së. Te faqja Nr. 25 është ndarë shpenzimi 1.145.000 €. Sa i përket projektit të huamarrjes thuhet se janë shpenzuar rreth 200.000€ ndërkaq që unë realisht nuk kam parë që është punuar diçka, përveç që i kemi pa disa Gypa. Kërkoj sqarim për të gjitha këto me shifra. Ne e dimë që dy muajt e fundit se si është bërë, mirëpo duhet me pas njëfarë proporcionaliteti, dhe gjithësesi që duhet një planifikim më i mirë.

z.Rexhep Gashi; Ne qdo herë do ti ndajmë shqetësimet e qytetarëve. Ne këtu në këtë Kuvend e kemi ngritur dorën për aprovimin e këtyre projekteve. Në raport thuhet se nuk janë përfshi të gjitha projektet, unë po kërkoj nga Zyrtarja Kryesore Financiare me na sqaruar pse nuk janë përfshi shumë projekte të vitit 2019 për të cilat ne e kemi ngritur dorën për ti aprovuar?

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Faleminderit për pyetjet. Unë mund të ju them se raporti dorëzohet edhe në Ministri, edhe ky raport është kontrolluar nga Auditori i përgjithshëm, dhe sigurisht që epet vlerësim për te. Sa i përket Shpenzimeve kontigjente, ne i paraqesim në qdo raport. Duhet me pas parasysh faktin se te këto shpenzime nuk dihet nëse rastet e procedurave gjyqësore do të humben apo do të fitohen. Pagesat që janë bërë për rastet që janë dalë në pension, këto raste nuk janë të vitit 2019 por janë shumë më të hershme. Kemi pas një shumë prej 7.000 e diçka euro për firmën "Ardhmëria" te faturat e pa paguara për fshatrat Belinc dhe Reqak. Janë edhe dy pagesa të tjera për te shtëpia e komunitetit dmth. ndërtimi i objektit të shtëpisë së komunitetit i cili nuk ka qenë në listën e projekteve për vitin 2019 mirëpo ne kemi qenë të detyruar për me i paguar obligimet e shpenzimeve që i kemi pas. Shpenzimi i buxhetit prej 85% është po që se e krahasojmë me buxhetin fillestar të aprovuar. Se sa është punuar në teren janë organet që e kanë për detyrë me bërë mbikqyrjen. Kemi edhe rastet e 8 puntoreve Lehona që duhet me i paguar.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, unë po lidhem te opozita që po e luan rolin e viktimës këtu, E kemi projektin e kanalizimit të Lagjës Ademaj që edhe vetë e keni votuar, e që nuk ka qenë në buxhet, e tash ju prap po bëni pyetje këtu.

z.Naim Zejna; Nuk është asgjë personale, kur diskutohet qështja e huamarrjes, pyetja është krejtësisht legjitime, ku janë shpenzuar paratë e këtij projekti, duhet të ketë pozicionim të Zyrtares Kryesore Financiare. Duhet të thuhet se është mirë ose nuk është mirë të sqarohet, sepse 200.000 € janë një shumë mjaft e madhe e parave. Edhe te firma "Ardhmëria" është shkelje sepse nuk ishte pozicion buxhetor.

z.Ruzhdi Jashari; I ke të pranuar në Administratë 15 shërbime kontraktuale, qështje specifike e votës, e pastaj më vonë i futë në kontratë. Shpenzimet administrative (përmenden disa sosh) janë shpenzime krejtësisht koti. Kush është ky Bujar Osmani, 45.000 €, pastaj qështja e Limanit, këto janë shpenzime ekstra të pa nevojë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota "Për" me 7 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" aprovoi Raportin Vjetor Financiar për vitin 2019.**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Dha 5 minuta pauzë në ora 11.45h. Mbledhja vazhdon në ora 11.50h.

Pika 4

Raporti tremujor buxhetor Janar-Mars 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi lexoi rekomandimin e KPF-së, për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Prezantoi raportin tre mujor për periudhën Janar-Mars 2020 në pikat kryesore sipas tabelave. Poashtu përmendi edhe bazën Ligjore për hartimin e raportit. Raportin e kemi përgatitur të shkruar dhe e keni marrë me kohë, (shih dokumentin). Unë nuk do ta zgjati më shumë por jemi këtu për të dhënë përgjigje në pyetjet e juaja eventuale.

z.Naim Zejna; Faleminderit për raportin tre mujor financiar. Unë kam vërejtje te shpenzimet, sepse shpenzimi i buxhetit prej 14.87% nuk është reflektim i shpenzimeve që është dashur ti kemi. Te kategoritë ekonomike kemi shpenzime të ndryshme (lexoi me shifra në tabela). Është e ditur se paratë i kemi pas në dispozicion, por ose nuk kemi ditë ose nuk kemi mundur me i shpenzuar ato.

z.Fehmi Hysenaj; Faleminderit për raportin. Siq e tha edhe parafolësi nuk na ka penguar shfaqja e Pandemisë KOVID19, ndoshta mund të themi për javën e fundit të saj sepse paraqitja e rastit të parë ka qenë mjaftë vonë. Shpenzimi i buxhetit prej 14.87% do të duhej të ishte rreth 25% por unë mendoj se pjesa e dytë do të jetë edhe më keq. Për hirë të situatës së vështirë unë kam mirkuptim dhe këtë raport do ta votoj.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për raportin. Është raport i parë për këtë vit, dmth për Janar-Mars. Në këtë periudhë kemi shpenzimet më të vogla se sa në periudhën e njejtë të vitit të kaluar. Po ashtu edhe te inkasimi i të hyrave vetanake i kemi shifrat e vogla, ku unë kërkoj që me bërë përpjekje që me u rritë të hyrat vetanake. Për mua është shqetësuese edhe realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë ku kemi vetëm 27.000€, pastaj te lejet e ndërtimit i kemi vetëm 4.100€ po ashtu edhe kjo vlerë duhet të rritet. Sa po shoh unë ndërtimet nuk po ndalen, vetëm në lagjen time Ademaj, kemi rreth 5 shtëpi të reja të ndërtuara. Zyrtarët duhet me i obliguar për leje me pagesën e tatimit në pronë. Pastaj duhet të shikohet se sa ne vetë anëtarët e Kuvendit i kemi kryer obligimet tatimore. Nëse nuk i kemi kryer atëherë qka presim ne nga qytetari. Unë e përkrahu këtë raport dhe do ta votoj. I ftoj qytetarët që ti paguajnë obligimet.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje. Disa kategori nuk kanë shpenzuar buxhet, pse këto kategori nuk e kan shpenzuar buxhetin e tyre?

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Po themi se buxheti i Kosovës nuk është aprovuar deri në muajin Mars, dhe ne kemi shkuar me 1/12 e buxhetit, dhe kjo pra ka qenë një pengesë. Alokimin e mjeteve e ka bërë Ministria, dhe e ka bërë me minus 20%.

z.Ruzhdi Jashari; Unë kam një pyetje, projektet e filluara gjatë vitit 2019 por edhe 2020 a i ka pamundësuar që firmat me i vazhduar punimet në këto projekte, sepse unë mendoj se për këto projekte janë bërë edhe zotimet e mjeteve financiare. Rastin e kemi te firma "Kadolli" kjo ka filluar punimet tash, edhe pse ka pas mundësi me filluar më herët dmth. edhe gjatë kohës së Pandemisë.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Te projektet dy vjeqare edhe nëse firma e ka kryer punën, pa e pranuar punën Komisioni, ajo nuk mund të paguhet. Nuk ka filluar asnjë projekt i ri. Projektet e vitit të kaluar të 2019 ato mund të vazhdojnë punën, dhe pagesa bëhet në bazë të punës që e ka kryer.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 14 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 4 vota "Abstenim" aprovoi Raportin Tremujor Buxhetor, Janar-Mars 2020.**

Pika 5

Rishikimi i Buxhetit për vitin 2020. (Pikë Shtesë)

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Pasi lexoi rekomandimin e KPF-së, për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha znj. Kimete Ukaj.

znj. Kimete Ukaj, ZKF; Prezantoi këtë pikë, duke lexuar propozimin e dhënë nga ekzekutivi për rishikimin e buxhetit për vitin 2020, të ndara sipas programeve buxhetore, që kryesisht lidhen me shpenzimet që janë bërë për parandalimin e përhapjes së Pandemisë KOVID19. Dokumentin e keni marrë me kohë, dhe po besoj e keni lexuar, i mirpres pyetjet e juaja, (shih dokumentin).

z. Naim Zejna; Pajtohem me rishikimin e buxhetit. Nuk pajtohem me rregullimin e hapsirave të gjelbërta për arsye se kemi nevojë më të madhe për rregullimin e varrezave kërkesë e kahmotshme dhe e domosdoshme. Prandaj unë propozoj që të ky projekt prej 40.000€ të merren 30.000€ dhe të qohen te projekti për rregullimin e varrezave në Shtime, dmth rregullimi i kaskadave të varrezat.

znj. Adelina Beqaj; Janë furnizuar disa mjete të shërbimit sociale, a mund ta di se për far shërbime janë dhënë 10.000€?

z. Fehmi Hysenaj; Unë kam parasysh shqetësimet, por ne duhet ti mbështesim vendimet e mëparshme të Kuvendit. Ne do ti pranojmë këto lëvizje të projekteve por që me KAB të përfshihen edhe këto projekte të propozuara.

z. Muhamet Ademaj; Edhe unë e përkrahu këtë rishikim të buxhetit.

z. Shefki Dauti; Në emër të grupit të deputetëve të PDK-së e përkrahim këtë rishikim të buxhetit dhe do ta votojmë.

z. Ruzhdi Jashari; Përsëri na nuk e kemi një raport të detajizuar për rishikimin e buxhetit. Pandemia e ka diktuar një ndarje të tillë të buxhetit, mirëpo para se me shkuar deri aty, duhet ta kemi një raport të detajuar. Tash e kemi nga Qeveria një kërkesë të ngutshme për rishikim të buxhetit. Unë mendoj se një ndarje e tillë shkon krejtësisht në disfavor të zhvillimit por para se gjithash në disfavor të interesit qytetar.

znj. Kimete Ukaj, ZKF; Mjetet janë marrë nga projektet që fare nuk kanë filluar. Meqenëse është lejuar një gjë e tillë për shkak të pandemisë. Nga 10 milion euro që janë paraparë për Komuna ne nuk kemi marrë asgjë, dhe nuk e di se ku janë derdhur ato mjete. Te shpenzimet sociale, janë shpenzime të rastet e varrimeve. Te projekti që e përmendi Naimi, nuk mundemi me i marrë mjetet dhe me e ndryshuar destinimin e tyre sepse ai është projekt dy vjeçar. Unë e përmenda se mundemi me ndërhy vetëm te projektet që nuk kanë filluar fare.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 15 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim" aprovoi Rishikimin e Buxhetit për vitin 2020.**

Pika 6

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Pasi lexoi rekomandimin e KPF-së, dhe njoftoi Kuvendin se KAB-i duhet të shkojë në diskutim publik, hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Fehmi Hysenaj; Unë propozoj që KAB-i të shkojë në diskutim publik për 30 ditë e jo për 15, meqenëse kemi të bëjmë me një dokument të rëndësishëm për qytetarët e komunës tonë.

znj. Kimete Ukaj, ZKF; Afatin për dorëzimin e KAB-it e kam deri më 30 Qershor, për këtë arsye duhet të shkojë në diskutim për 15 ditë. Mendoj se Anëtarët e KPF-së duhet të jenë pjesëmarrës aktiv në debat.

z.Muhamet Ademaj; Propozoj që KAB-i të shkojë në diskutim publik për 15 ditë por që debati të organizohet edhe nëpër fshatra, edhe pse faktikisht po na mungojnë Kryetarët e fshatrave për ta bërë organizimin e këtyre debateve.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi që Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 ta qojë në diskutim publik për 15 ditë.**

Pika 7

Rishqyrtimi i vendimeve të Kuvendit sipas raportit të vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ë

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sqaroi se, arsyeja e kthimit në rishqyrtim të këtyre dy vendimeve nga MAPL-ja është mungesa e Planit Zhvillimor. Në vazhdim Kryesuesja lexoi edhe rekomandimin e Zyrtarit Ligjor, i cili ka rekomanduar që vendimet të anulohen deri në miratimin e Hartave Zonale. Po ashtu lexoi edhe rekomandimin e KPF-së që ka rekomanduar të njëjtën, anulimin e vendimeve deri në aprovimin e Hartave Zonale.

znj.Adelina Beqaj; Mua po më intereson me ditë se nëse bëhen Hartat Zonale atëherë mirë por nëse nuk bëhen kush do të mirret me këto qështje?

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Drejtorja për Planifikim Urban. Kadastër dhe Gjeodezi do të merret me këto qështje.

z.Muhamet Ademaj; Në këtë Kuvend kemi vendosur, për këto vendime dhe kemi bërë përçarje shumë të mëdha në fshatin Petrovë, prandaj përgjegjësini e ka ky Kuvend.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Aprovimin e vendimeve e kemi bërë me qëllimin më të mirë, për qka edhe jemi këtu.

z.Naim Zejna; Unë pata një pyetje, kam problem të funksionimit me automatizëm dmth.der i miratimi i Hartave Zonale. Unë mendoj se më e drejtë është të thuhet pezullimi i vendimeve se sa të thuhet anulimi i tyre.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Rekomandimi i MAPL-së është ashtu si rezultat i konsultimeve që i kemi pas me ta kanë thënë se për shkak të Pandemisë nuk i kemi pas vlerësimet. Asgjë nuk ka jashtëligjore, pengesa dmth. është mungesa e Planeve Zhvillimore.

z.Fehmi Hysenaj; Nuk ka diskutim që është shkelje ligjore, sepse ashtu thuhet në shkresën e MAPL-së. Pas miratimit të Hartave Zonale për këto qështje nevojitet edhe kërkesë e re edhe vendim i ri.

z.Ruzhdi Jashari; Kemi luajtë me nervat e qytetarëve në fshatin Petrovë. Tri Ministri janë marrë me këtë qështje. Nëse është kështu, atëherë ne Harta Zonale nuk kemi as për ndërtimin e objekteve sportive e as për objekte të tjera institucionale, Hartat Zonale pra vlejné për të gjitha ndërtimet e jo veq për këto dy objekte.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Qështjet e njëjta nuk do ti trajtojmë pavarësisht nga këto. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 14 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim" aprovoi Anulimin e vendimeve të Kuvendit sipas raportit të vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ë me numër Npi-01/389 dhe Npi-01/390, bazuar në Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të Zyrtarit Ligjor deri në miratimin e Hartave Zonale.**

Pika 8

Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi lexoi rekomandimin e KPF-së për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha znj.Agime Roshaj.

znj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi para Kuvendit, Propozim-Vendimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zavendës drejtorëve të shkollave. Propozim-Vendimin e keni marrë me kohë. Ne si ekzekutiv kemi emëruar Fatmir Zymerin zyrtar për arsim dhe Basri Hyseni Kryetar i Këshillit të Prindërve. Tani për ta kompletuar Komisionin mbetet edhe zgjedhja e dy anëtarëve nga Kuvendi.

z.Perparim Ramusa; Me sa e kuptuam kemi një Udhëzim Administrativ nga Ministria e Arsimit, në bazë të cilit obligohet ekzekutivi që ti propozoj dy anëtarë dmth. një nga ekzekutivi dhe një nga këshilli i prindërve. Në emër të grupit të anëtarëve të Kuvendit, ne nga PDK-ja jemi që të aprovohet ky vendim.

z.Besnik Seferi; Edhe unë mendoj se nuk duhet me qenë kundër, sepse me udhëzim caktohet se kush mundet me qenë i propozuar. Nuk është e keqe nëse kemi një transparencë në këtë qështje. Është si kërkesë e imja që të na epet një sqarim për punën e Komisionit për ndarjen e bursave.

znj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA; Në secilin Komision munden me qenë edhe dy anëtarë vëzhgues.

z.Fehmi Hysenaj; Faleminderit, për drejtoreshën që na ke respektuar si Kuvend. Sa i përket Komisionit mendoj se më vonë do të shihet për sa i përket punës së tijë, sepse ka ndodhur që janë zgjedhur të mirë por janë detyruar me dhënë dorëheqje. Kërkoj që puna e Komisionit të jetë sa më transparente.

z.Shefki Dauti; Në parim unë jam për, e qka nëse ne nuk i votojmë. Ku është logjika e Udhëzimit Administrativ. Pse pra ky formim i Komisionit po kalon nëpër Kuvend.

z.Naim Zejna; Për sa i përket ndarjes së bursave për studentë ku është roli i Kuvendit? Nuk mundemi me zgjedhë, duhet ti votojmë propozimet. Tjetra ne duhet ti votojmë anëtarët e komisionit komplet të gjithë edhe anëtarin e Ministrisë. Kuvendi mundet me i votuar por mundet edhe mos me i votuar.

znj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA; Ju jeni të obliguar me i votuar sepse detyroheni sipas Ligjit e jo sipas meje.

z.Ruzhdi Jashari; Kjo pra është qështje tejet konfuze. Unë desha ta pyes drejtoreshen se a ke ndonjë drejtor ose zëvendës-drejtor shkolle që tani i kalon afati, a krejt janë Ushtrues Detyre?

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 16 vota "Për" me 2 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" aprovoi Vendimin për formimin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar sipas kriterëve të Konkursit në postin e Drejtorit, përkatësisht Zëvendës-Drejtorit, në Institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes, për të gjitha konkurset që do të shpallen gjatë vitit shkollorë 2020/2021 përkatësisht deri më 31 Gusht 2020, si vijon:**

Anëtar i Komisionit nga Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht nga DKA:

1. **Fatmir Zymeri** – Zyrtar për Arësim,

Anëtar i Komisionit nga Këshilli i Prindërve të Nxënësve në Komunën e Shtimes:

2. **Basri Hyseni** – Kryetar i Këshillit të Prindërve.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 13.03h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

